



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Vendim nr. 237/3

“Mbi korigjimin e vendimi nr. 237 datë 12.2.2020”

Sot në datë 15.4.2020, trupi gjykues, e përbërë nga:

Olsi Komici	(Kryesues)
Firdes Shuli	(Relatore)
Brunilda Bekteshi	(Anëtare)

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

U mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Firdes Shuli, për korigjimin e një gabimi material në vendimin e subjektit të rivlerësimit Adnand Xhelili:

Në faqen 3, të vendimit nr. 237 datë 12.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në pikën II “Faktet dhe provat mbi të cilën është marrë vendimi”, paragrafi II.1.1 “Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja, fjalia “..subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave” të korigjohet me fjalinë “..subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave”.

Trupa pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësia është dukshëm si pasojë e një gabimi material,

V E N D O S I:

1. Në faqen 3, të vendimit nr. 237 datë 12.2.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në pikën II “Faktet dhe provat mbi të cilën është marrë vendimi”, paragrafi II.1.1 “Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja, fjalia “..subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave” të korigjohet me fjalinë “..subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.

3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjyqësor

Olsi Komici

(Kryesues)

Firdes Shuli

(Relatore)

Brunilda Bektashi

(Anëtare)



Sekretare gjyqësore
Anisa Duka